

A e dinit se...

Prindërve tuaj u ndalohej:

- ◇ Të shihnin kanale të huaja televizive apo të dëgjonin stacione të huaja radioje.
- ◇ Të shprehin lirshëm mendimet e tyre.
- ◇ Të bënin komente kritike apo të shprehnin pakënaqësi ndaj regjimit.
- ◇ Të udhëtonin jashtë shtetit për çfarëdolloj arsyeje.
- ◇ Të praktikonin rite fetare.

Këto veprime konsideroheshin shkelje e ligjit dhe dënoheshin nga Kodi Penal.

Prindërve tuaj u ndalohej:

- ◇ Të transferoheshin në ndonjë qytet apo fshat tjetër pa "pashaportizim" (që do të thotë: pa leje dhe pa marrë një punë nga Shteti).
- ◇ Të shkëmbejnë korrespondencë me të afërmit e tyre (jashtë vendit) në konfidencialitet. Çdo letër hapej dhe lexohej nga një zyrë e veçantë, e cila kontrollonte dhe spiunonte dhe që ishte pjesë e "Shërbimeve Sekrete".



Nëse një anëtar i familjes persekutohej politikisht:

Mund të internoheshin të gjithë anëtarët e familjes, duke përfshirë edhe fëmijët nën 14 vjeç.

- ◇ Asnjë i ri në familje nuk kishte të drejtën e studimit.
- ◇ Të afërmit e tyre pushoheshin nga çdo punë zyrtare dhe dërgoheshin "në terren", ku detyroheshin të bënin punë të rënda .

Disa shifra* rreth persekutimit politik:

Gjatë viteve 1945-1990 në Shqipëri:

- ◇ 5,577 burra dhe 450 gra u ekzekutuan për shkaqe politike (me ose pa gjyq);
- ◇ 17,900 persona u dënuan për shkaqe politike (10,533 burra dhe 7,367 gra);
- ◇ 30,383 persona u internuan për shkaqe politike;
- ◇ 952 persona vdiqën në burgje;
- ◇ 7,022 persona vdiqën në internim;
- ◇ Më shumë se 100 persona u vranë vetëm në vitin 1990 gjatë përpjekjeve për të kaluar kufirin;
- ◇ 408 u sëmurën mendërisht nga torturat.

* Sipas të dhënave të mbledhura nga QSHRT.

Dënimi për herë të dytë dhe internimet:

- ◇ Dy revolta të të burgosurve politikë, në Spaç (1973) dhe në Qafë-Bari (1984), u pasuan nga masa të rrepta dënimesh për herë të dytë: më shumë se 300 persona u dënuan për periudha më të gjata, kurse 6 u ekzekutuan.
- ◇ Në vitin 1979, më shumë se 50 persona u dënuan për herë të dytë, kurse 3 u persekutuan në Spaç pas një letre drejtuar Enver Hoxhës, ku të burgosurit politikë i referoheshin regjimeve më të buta komuniste në vende të tjera të Evropës Lindore .
- ◇ Mendohet se numri i personave të dënuar për herë të dytë ishte më i madh se 500 persona.
- ◇ Njerëzit zakonisht internoheshin fillimisht për 5 vjet. Më vonë, në shumicën e rasteve, kjo masë përsëritej disa herë nga Komisioni i Internimeve. Prandaj, disa vetë u internuan për 30 vjet ose më shumë.

Trajtim çnjerëzor

Nëse pyesni ata që kanë mbijetuar, do të mësoni rreth:

- ◇ rrahjeve për vdekje,
- ◇ ngacmimit të plagëve të hapura dhe vënies kripë në to,
- ◇ djegjeve me cigare,
- ◇ torturave me korrent elektrik,
- ◇ përdorimit të jelekëve të forcës,
- ◇ ditëve pa bukë e ujë,
- ◇ varjeve me kokë poshtë,
- ◇ vendosjes së vezëve të ziera në sqetulla,
- ◇ futjes së gozhdëve në thonj dhe dhjetëra forma të tjera torturash.



Genocidi Komunist, Muzeu Kombëtar: Fotografi të intelektualëve të persekutuar dhe internuar

